

URDHËR
Nr. 1063, datë 28.10.2025

**PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE PËR
ZËVENDËSMINISTRIN PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”,

URDHËROJ:

1. Znj. Vilma Premti, zëvendësministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen e zbatimit të prioriteteve dhe të objektivave të Shërbimit të Jashtëm, me qëllim energjezimin e strukturave, monitorimin, ndjekjen e politikave dhe praktikave të burimeve njerëzore, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon shërbimin e jashtëm;

b) Ndjekjen dhe mbikëqyrjen e politikave dhe veprimtarisë konsullore, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve ndaj qytetarëve;

c) Ndjekjen e procesit të hartimit dhe të zbatimit të politikave dhe akteve ligjore, në përputhje me prioritetet dhe objektivat e përcaktuar në aktet rregullatore përkatëse;

d) Koordinimin dhe ndjekjen e procesit të hartimit të akteve dhe procedurave administrative të brendshme, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në praktikë;

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 923, datë 28.10.2024. “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Elisa Spiropali